

VENDIM
Nr. 163, datë 1.3.2017

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË
VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 8.3 HA NË OBJEKTIN “HIJA E ZOGAJVE”, TË QARKUT
KUKËS, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “NNT.PRO-ING” SHPK PËR
SHFRYTËZIMIN E MINERALIT
TË KROMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 8.3 ha, që shtrihet në ngastrën nr. 75, në objektin “Hija e Zogajve”, të ekonomisë pyjore “Stoberdë”, në qarkun e Kukësit, e cila përdoret nga shoqëria “NNT.PRO-ING” sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit të kromit, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullor publik, të pakësohet në volum dhe të regjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për sipërfaqen pyjore, dhe harta topografike, me koordinatat e sipërfaqes objekt minerar, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor dhe të produkteve të tjera pyjore e kullorore, në sipërfaqen objekt minerar, paguhen nga shoqëria “NNT.PRO-ING” sh.p.k. në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “NNT.PRO-ING” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet në përdorim sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda vitit të parë, të pyllëzojë me fondet e veta një sipërfaqe pyjore prej 8.3 ha në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit.

4. Sipërfaqja pyjore dhe kullorore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbetet pronë publike e shtetit dhe regjistrohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën regjistrimin e sipërfaqes pyjore dhe kullorore të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, nga shoqëria “NNT.PRO-ING” sh.p.k., sipërfaqja pyjore e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullor publik.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe shoqëria “NNT.PRO-ING” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA
FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
MINERAR NGA SHOQËRIA "NNT.PRO-ING" sh.p.k. në qarkun e KUKËSIT**

QARKU KUKËS

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullosore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Perdorimi territorit</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)</i>
KU37 00 075	EP Stoberdë	75	shkurre	Ministria Mjedisit	8.3
GJITHSEJ					8.3

PLAN VENDOSJE
E ZONËS MINERARE Nr.250(Zogaj)
Objekti: "Hija e Zogaj"

Shkalla 1 : 10 000

